



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 500/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.07.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk dhe “Nazeri 2000” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-58555-03-26-2018 me objekt: Loti II: “Shërbim me roje civile Zyrat e Sektorit Kukës dhe Skrapin në Trull Surroi (Kukës)”, me fond limit 6 124 789 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 23.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

Lënien të skualifikuar si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit shoqërive “Toni Security” shpk dhe “Sabeta” shpk dhe “Orka” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër  
Lagjia: “3 Heronjtë”, Rruga: “At Zef Valentini”, Shkodër.

**Ankimues** Operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k.  
*Adresa:* Njësia Nr. 7, Ish Fusha e Aviacionit, Godina Nr. 22 Pallati.nr. 2 Kati 3, Ap. 9 Tiranë.

**Subjekt i interesuar:** “Nazeri 2000” shpk

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën. 1, të nenit. 63, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.03.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-58555-03-26-2018 me objekt: Loti II: “Shërbim me roje civile Zyrat e Sektorit Kukës dhe Skrapin në Trull Surroi (Kukës)”, me fond limit 6 124 789 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 23.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

II.2. Në datën 24.04.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar raportit të auditimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “Eurogjici Security” shpk	5.831.852,90	lekë	kualifikuar
2. “Nazeri 2000” shpk	5.831.852,90	lekë	kualifikuar
3. “Trezhnjeva” shpk	5.831.852,90	lekë	kualifikuar
4. “Sabeta” shpk	5.831.852,90	lekë	skualifikuar
5. “Toni Security” shpk	5.831.852,90	lekë	skualifikuar
6. “Orka” shpk	5.831.940,80	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 09.05.2018, operatori ekonomik “Trezhnjeva” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kërkon shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk dhe “Nazeri 2000” shpk, duke pretenduar skualifikimin e tyre, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit dhe mbetjen të skualifikuar të operatorëve ekonomik “Toni Security” shpk, dhe “Sabeta” shpk dhe “Orka” shpk në këtë procedurë prokurimi me pretendimet si më poshtë vijon:

*[...] Në bazë të nenit 63/6, të Ligjit nr. 9643, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, po paraqesim këtë ankim, duke parashtruar si vijon: Kërkojmë skualifikimin e firmës “Eurogjici Security” shpk. Në dokumentat e tenderit është kërkuar: “Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit, konform Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008.”.*

*Operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë lot që të kualifikohen duhet të kenë licencë për radio ndërlidhëse dhe radio alarmi për arsye të distancës së njëjës nga vendrojet (objektit) nga qendrat e banura.*

*Autorizimi AKEP nuk mbulon zonën ku ndodhet objekti Zyrat Kukës, Truall Surroj Kukës sipas kapacitetit teknik referojmë kapacitetin teknik [...] Autorizimi AKEP nuk mbulon zonën ku ndodhet objekti Zyrat Kukës Truall Surroi sipas pikës kapaciteti teknik: Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi në emër të shoqërisë konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në RSH” Radioalarmi me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km në vendodhje maja e Hekurave Tropojë nuk mbulon Zyrat Kukës Truall Surroj Kukës. Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Zyrat Kukës Truall Surroj Kukës. Kërkojmë skualifikimin e firmës "Nazeri2000" shpk, pasi nuk nuk plotëson kërkesat si më poshtë: Nuk plotëson kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit tek Shtojca 1. Firma “Nazeri 2000” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas pikes 2, të DST, pasi nuk ka paraqitur preventivin për 1 vendroje me 4.98 roje/muaj, kriter i përcaktuar nga autoriteti kontraktor ku detyron ofertuesit që për tu kualifikuar, bashkëlidhur formularit të çmimit të*

ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vendroje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës dhe përcaktimeve në dokumentat e procedurës së prokurimit.

Vërtetimi i Polisisë së Qarkut Kukës është me korigjim data e lëshimit cka bën të pavlefshëm këtë dokument, pasi humb thelbin dhe arsyen e kërimit të këtij dokumenti.

Në DST është kërkuar: “Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit, konform Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008.”

Operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë lot që të kualifikohen duhet të kenë licencë për radio ndërlidhëse dhe radio alarmi për arsye të distancës së njërës nga vendrojet (objektit) nga qendrat e banura.

Autorizimi AKEP nuk mbulon zonën ku ndodhet objekti Zyrat Kukës, Truall Surroj Kukës sipa kapacitetit teknik referojmë kapacitetin teknik [...]Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Zyrat Kukës Truall Surroj Kukës.

Kërkojmë të mbetet i skualifikuar firma “Toni Security” shpk dhe arsyeve të skualifikimit ti shtohet arsyeja se: Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë pika 3, në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur 10 çertifikata të vlefshme të lëshuara nga Drejtoria e Policisë Qarkut, Kukës brenda afatit 4-vjeçar të vlefshemrisë, të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".

Nuk ka paraqitur vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës. Nuk ka paraqitur Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit Shërbimit nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës.

Nuk ka paraqitur autorizim individual akep zonë të cilën kryhjet shërbimi i ruajtjes zyrat kukës truall surroj Kukës.

Kërkojmë të mbetet i skualifikuar firma “Sabeta” shpk dhe arsyeve të skualifikimit ti shtohet arsyeja se:

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga AK-ja sipas pikës 2 të DST, nuk ka paraqitur preventiivin për 1 vendroje me 4.98 roje /muaj , kriter ky i përcaktuar nga AK-ja ku detyron ofertuesit që për tu kualifikuar bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventive për një vendroje me tre turne (4.98) në muaj sipas tabelës.

Sipas informacioneve rezulton të ketë detyrime që përfshijnë dhe interesa të papaguara përkatësisht për zërin “Tatim mbi Vlerën e Shtuar” “Tatim mbi Fitimin” “Kontribute të Sigurimeve Shoqërore” “Tatim mbi të ardhurat personale”. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës me nr. 9 prot. Datë 26.01.2018 rezulton me detyrime tatimore në bazë të aktmarveshjes me sektorin e borxhit vërtetimi pasqyron se ka detyrime tatimore deri më 26.01.2018 në shumën 3.037.370 lekë.

Shtojca 7 Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme është deklarim i rremë pasi rezulton me detyrime tatimore, Shtojca 5 Deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike Shtojca 6 Deklaratë mbi konfliktin e interes, data e deklarimit nuk i përket datës së zhvillimit të procedurës cka e bën të pavlefshëm këtë document pasi humb thelbin dhe arsyen e kërimit të këtij dokumenti.

*Kërkojmë të mbetet i skualifikuar “ORKA” shpk dhe arsyeve të skualifikimit ti shtohet arsyeja Në dst kërkohet Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit Shkodër, Fushë Arrës, konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008.*

*Operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë lot që të kualifikohen duhet të kenë licencë për radio ndërlidhëse dhe radio alarmi për arsye të distancës së njërës nga vendrojet (objektit) nga qendrat e banura.*

*Nuk ka paraqit Autorizimi AKEP për zonën ku ndodhet objekti Zyrat Kukës, Truall Surroj Kukës sipa kapacitetit teknik referojmë kapacitetin teknik [...]Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Zyrat Kukës Truall Surroj Kukës.*

*Nuk ka paraqitur vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.Vërtetimi i Energjisë Elektrike është për Z. Rr.S. i cili nuk ka asnjë lidhje ligjore me firmën “Orka” shpk si titular dhe jo më në emër të firmës “Orka”*

*Firma “Orka” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga AK-ja sipas pikës 2 të DST, nuk ka paraqitur preventyivin për 1 vendroje me 4.98 roje /muaj , kriter ky i përcaktuar nga AK-ja ku detyron ofertuesit që për tu kualifikuar bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventive për një vendroje me tre turne (4.98) në mmuaj sipas tabelës.*

*Si përfundim kërkojmë:*

*Së pari: Marrjen parasysht të ankesës tonë.*

*Së dyti: Pezullimin e procedurës deri në shqyrtim të plotë të ankesës tonë.*

*Së treti: Skualifikimin e firmes “Eurogjici Security” shpk, “Nazeri 2000” shpk për arsyet e mësipërme, mbetjen të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për “Toni Security” shpk, “Sabeta” shpk dhe “Orka” shpk për arsyet e mësipërme.*

II.5. Në datën 16.05.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar ankesën.

II.6. Në datën 21.05.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Trezhnjeva” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime që kishte parashtruar tek autoriteti kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 218 prot., datë 28.05.2018, protokolluar me tonën nr.948/2prot., datë 04.06.2018 me objekt “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk me arsyen se: “Në dokumentat e tenderit është kërkuar: “Kërkojmë skualifikimin e firmës “Eurogjici Security” shpk. Në dokumentat e tenderit është kërkuar: “Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit, konform Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008.”.

*Operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë lot që të kualifikohen duhet të kenë licencë për radio ndërlidhëse dhe radio alarmi për arsye të distancës së njëjës nga vendrojet (objektit) nga qendrat e banura.*

*Autorizimi AKEP nuk mbulon zonën ku ndodhet objekti Zyrat Kukës, Truall Surroj Kukës sipas kapacitetit teknik referojmë kapacitetin teknik [...]Autorizimi AKEP nuk mbulon zonën ku ndodhet objekti Zyrat Kukës Truall Surroi sipas pikës kapaciteti teknik: Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi në emër të shoqërisë konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në RSH” Radioalarmi me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km në vendodhje maja e Hekurave Tropojë nuk mbulon Zyrat Kukës Truall Surroj Kukës. Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Zyrat Kukës Truall Surroj Kukës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në Shtojcën.7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik”, pika 2 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*“Autorizim Individual për operatorin ofertues lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për “Radiokomunikim”, konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, ku të përfshihet qyteti i Kukesit, ”.*

III.1.2. Në shtojcën.11 “Shërbimet dhe grafiku i shërbimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përcaktohen elementët e shërbimit si më poshtë:

*Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Shërbim me roje civile” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.*

*(I ndarë sipas loteve)*

*LOTI II: Objekti “Shërbim me roje civile Zyrat e Sektorit Kukes dhe Skrapin ne Trull Surroi (Kukes).*

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

*Autorizim Individual” nr. AI-U1396, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), më datë 03.03.2015, në emër të shoqërisë “Eurogjici Security” shpk;*

*Aneks nr.2/1 (AKEP-2015-AI-U1396-1-1) “Për caktim dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF, sisteme radiokomunikimi”, Vendi i instalimit “Lagjia 1 Pall.12 Krumë” dhe Vendi i Instalimit: “Shkolla 8 vjeçare Muja Has”, me zonë ofrimi shërbimi për sisteme radiokomunikimi Qarku Kukës – 45 km, me kohë përdorimi të frekuencave nga 03.03.2015-31.12.2020.*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.5. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*“a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose[...].”*

III.1.6. Në nenin 66, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave , për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji.”*

Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se: *“Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b)frekuencat e përfituara ; c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji”*.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës

në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk Komisioni gjykon se operatori në fjalë me anë të dokumentacionit të paraqitur dëshmon se disponon autorizim lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, referuar skemës së organizimit të shërbimit me sisteme radiokomunikimi, KPP gjykon se operatori ekonomik plotëson kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në autorizimin individual të paraqitur, referuar vendit të instalimit, distancës në kilometra të përcaktuar në këtë autorizim; përfshihen në frekuencë radiokomunikimi distancat reale të qyteteve ku do të kryhet shërbimi i kërkuar, sipas përcaktimeve të zonave të specifikuara nga autoriteti kontraktor.

Akoma më tej lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k. mbi ofertën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security”sh.p.k. me arsyetimin se: “[...] Radioalarmi me zonë mbulimi Qarku Kukës 35 km në vendodhje maja e Hekurave Tropojë nuk mbulon Zyrrat Kukës Truall Surroj Kukës.[...]”, Komisioni konstaton se, ky është një kriter i pakërkuar nga autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk ka përmbushur kriterin e kualifikimit, të kërkuar në dokumentat statndarte të tenderit nga autoriteti kontraktor.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk me arsyen se: “Firma “Nazeri 2000” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas pikes 2, të DST, pasi nuk ka paraqitur preventivin për 1 vendroje me 4.98 roje/muaj, kriter i përcaktuar nga autoriteti kontraktor ku detyron ofertuesit që për tu kualifikuar, bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vendroje me 3 turne (4.98 roje) në muai, sipas tabelës dhe përcaktimeve në dokumentat e procedurës së prokurimit” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën.7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik”, pika 8 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)”.



III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën.1 “Formularin e Ofertës Ekonomike” si më poshtë:

“Shtojca 1

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

### FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendr ojeve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Shërbim me roje civile për Objektet e Drejtorisë Rajonit Verior Shkodër (të ndara sipas loteve)	12		4.98		
	<b>Oferta Neto ne total</b>					
	<b>TVSH (%)</b> (X)					
	<b>Oferta total</b> (X)					

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

**Sqarime**

1. Në çmim janë të përfshira ëte gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vend roje me tre turne.
2. Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>
<b>1</b>	<i>Shpenzime për pagë bazë</i>
<b>2</b>	<i>Shtesë mbi pagë për turnin II</i>
<b>3</b>	<i>Shtesë mbi pagë për turnin III</i>
<b>4</b>	<i>Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%</i>

#### *Analiza e kostos*

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje me tre turne të llogaritet **4.98 (Orë pune/punonjës/muaj: 174 orë)**. Koefficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar në dokumentat e tenderit).

III.2.3. Nga shqyrtimi i ofertës së ekonomike të dorëzuar nga shoqëria "Nazeri 2000" shpk rezulton se është paraqitur formulari i ofertës sipas Shtojcës 1, si dhe analiza e kostos në të cilën pasqyrohet vetëm analiza e kostos për një roje në muaj, ndërkohë që mungon analiza e kostos për një vendroje në muaj.

III.2.4. Referuar nenit 53, pika 3 dhe 4 të LPP-së, ku përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se formulari i ofertës i paraqitur nga shoqëria "Nazeri 2000" shpk është sipas Shtojcës.1, por i mungon një nga elementët dhe konkretisht analiza e kostos për një vendroje në muaj, sikurse është përcaktuar në dokumentat e tenderit, duke mos përmbajtur të gjithë elementët e nevojshëm për krahasimin e ofertës.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "Trezhnjeva" shpk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik është pranuar dhe gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke plotësuar kështu interesin e ligjshëm të ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës, Toni Security” shpk, dhe “Sabeta” shpk dhe “Orka” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 08.05.2018, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i kryer nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të kenë paraqitur ankesë në KPP në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës “Toni Security” shpk dhe “Sabeta” shpk dhe “Orka” shpk, nuk do të merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-58555-03-26-2018 me objekt: Loti II: “Shërbim me roje civile Zyrat e Sektorit Kukës dhe Skrapin në Trull Surroi (Kukës)”, me fond limit 6 124 789 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 23.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Trezhnjeva” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 948 Protokoli; Datë 21.05.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**  
**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**